

No. 53642*

**Belgium
and
Albania**

Agreement between the Kingdom of Belgium and the Republic of Albania on the transfer of sentenced persons. Brussels, 29 July 2010

Entry into force: *1 December 2013, in accordance with article 4*

Authentic texts: *Albanian, Dutch, English and French*

Registration with the Secretariat of the United Nations: *Belgium, 16 May 2016*

**No UNTS volume number has yet been determined for this record. The Text(s) reproduced below, if attached, are the authentic texts of the agreement /action attachment as submitted for registration and publication to the Secretariat. For ease of reference they were sequentially paginated. Translations, if attached, are not final and are provided for information only.*

**Belgique
et
Albanie**

Accord entre le Royaume de Belgique et la République d'Albanie sur le transfèrement des personnes condamnées. Bruxelles, 29 juillet 2010

Entrée en vigueur : *1^{er} décembre 2013, conformément à l'article 4*

Textes authentiques : *albanais, néerlandais, anglais et français*

Enregistrement auprès du Secrétariat des Nations Unies : *Belgique, 16 mai 2016*

**Aucun numéro de volume n'a encore été attribué à ce dossier. Les textes disponibles qui sont reproduits ci-dessous sont les textes originaux de l'accord ou de l'action tels que soumis pour enregistrement. Par souci de clarté, leurs pages ont été numérotées. Les traductions qui accompagnent ces textes ne sont pas définitives et sont fournies uniquement à titre d'information.*

**MARRËVESHJE
NDËRMJET
MBRETËRISË SË BELGJIKËS
DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MBI TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR**

MBRETËRIA E BELGJIKËS

DHE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

TË INTERESUARA për nxitjen e marrëdhënieve të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet të dy Shteteve dhe në veçanti forcimin e bashkëpunimit ligjor,

ME DËSHIRËN për të zgjidhur me marrëveshje të përbashkët çështjet në lidhje me transferimin e personave të dënuar, duke respektuar ndërkohë parimet themelore të të drejtave të njeriut të pranuar botërisht,

ME DËSHIRËN për të lejuar personat e dënuar të vuajnë periudhën e tyre të burgimit në vendin e të cilit janë shtetas, me qëllim lehtësimin e ri-integrimit të tyre social,

TË VENDOSURA në këtë frymë, për të ruajtur në nivelin më të lartë të mundshëm, përveç rregullave dhe kushteve të Konventës Evropiane mbi Transferimin e Personave të Dënuar, të nënshkruar në Strasburg më 21 mars 1983, edhe bashkëpunimin e ndërsjellë në transferimin e personave të dënuar me heqje lirie,

KANË RËNË DAKORD si më poshtë:

Neni 1

Dispozitë e përgjithshme

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Marrëveshje interpretohen brenda kuptimit të Konventës Evropiane mbi Transferimin e Personave të Dënuar, të nënshkruar në Strasburg më 21 mars 1983.

Neni 2

Personat e dënuar që i nënshtrohen një urdhri dëbimi ose deportimi

1. Me kërkesën e Shtetit dënues, Shteti ekzekutues mundet, në bazë të dispozitave të këtij Neni, të bjerë dakord mbi transferimin e një personi të dënuar pa miratimin e atij personi, kur dënimi i dhënë ndaj këtij të fundit ose një vendim administrativ në vijim të atij dënimi, përfshin një urdhër dëbimi ose deportimi ose çdo masë tjetër si rezultat i të cilës ai person nuk do të lejohet më të qëndrojë në territorin e Shtetit dënues kur ai ose ajo lirohet nga burgu.
2. Shteti ekzekutues nuk jep miratimin e tij për qëllime të paragrafit 1 para se të ketë marrë në konsideratë opinionin e personit të dënuar.
3. Për qëllime të zbatimit të këtij Neni, Shteti dënues i jep Shtetit ekzekutues:
 - a) një deklaratë që përmban opinionin e personit të dënuar në lidhje me transferimin e tij ose të saj të propozuar, dhe
 - b) një kopje të urdhrit të dëbimit ose deportimit ose çdo urdhër tjetër, i cili ka efektin që personi i dënuar të mos lejohet më të qëndrojë në territorin e Shtetit dënues kur ai ose ajo lirohet nga burgu.
4. Çdo person i transferuar sipas dispozitave të këtij Neni nuk procedohet, dënohet ose arrestohet, me qëllim zbatimin e një vendimi ose urdhri ndalimi për çdo veprë penale të kryer para transferimit të tij ose të saj, të ndryshme nga ajo për të cilin ishte dhënë dënimi që duhet të zbatohet, atij ose asaj as nuk i kufizohet liria e tij ose e saj personale për ndonjë arsye tjetër, përveç rasteve të mëposhtme:
 - a) kur Shteti dënues e autorizon këtë: paraqitet një kërkesë për autorizim, e shoqëruar nga të gjitha dokumentet përkatëse dhe një dokumentim ligjor të çdo deklaratë të bërë nga personi i dënuar; autorizimi jepet kur vepra penale për të cilën kërkohet ky autorizim do të ishte subjekt ekstradimi sipas ligjit të Shtetit dënues ose kur ekstradimi do të përjashtojë vetëm për arsye të masës së dënimit;
 - b) kur personi i dënuar që ka pasur mundësi të largohet nga territori i Shtetit ekzekutues, nuk e ka bërë këtë brenda 45 ditëve nga lirimi i tij ose i saj përfundimtar, ose nëse ai ose ajo është kthyer në atë territor pasi është larguar prej tij.
5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 4 të këtij Neni, Shteti ekzekutues mund të marrë masat e nevojshme sipas ligjit të tij, duke përfshirë procedimet në mungesë për të parandaluar çdo efekt ligjor të kalimit të kohës.

Neni 3

Zbatimi i përkohshëm

Kjo Marrëveshje është e zbatueshme për zbatimin e dënimeve të dhëna para ose pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 4

Dispozita përfundimtare


1. Secili prej Shteteve Kontraktues njofton tjetrin për përfundimin e procedurave të kërkuara sipas Kushtetutës së tij në lidhje me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas datës së njoftimit të fundit.
2. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të papërcaktuar kohe.
3. Çdo Shtet Kontraktues mund të denoncojë këtë Marrëveshje në çdo kohë. Ky denoncim do të hyjë në fuqi një vit pas datës së marrjes të njoftimit të tij nga Shteti tjetër Kontraktues.

NË DËSHMI SA MË SIPËR, përfaqësuesit e të dy Shteteve, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar dhe vulosur këtë Marrëveshje.


BËRË në dy kopje në Bruksel, më 29 Korrik 2010, në gjuhën Frënge, Holandeze, Shqipe dhe Angleze ku të katër tekstet janë njëjloj autentik. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR MBRETËRINË E BELGJIKËS:

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË:



Yves LETERME,
Kryeministër



Sali BERISHA,
Kryeministër

[DUTCH TEXT – TEXTE NÉERLANDAIS]

**OVEREENKOMST
TUSSEN
HET KONINKRIJK BELGIË
EN
DE REPUBLIEK ALBANIË
INZAKE DE OVERBRENGING VAN GEVONNISTE PERSONEN**

HET KONINKRIJK BELGIË

EN

DE REPUBLIEK ALBANIË

ERNAAR STREVENDE de vriendschappelijke betrekkingen en de samenwerking tussen beide Staten, inzonderheid de gerechtelijke samenwerking tussen beiden te bevorderen,

ERNAAR STREVENDE in gemeen overleg de aangelegenheden betreffende de overbrenging van gevonnisse personen te regelen met eerbied voor de universeel erkende fundamentele mensenrechtenbeginselen,

ERNAAR STREVENDE gevonnisse personen de mogelijkheid te bieden hun vrijheidsberovende straf te ondergaan in het land waarvan zij onderdaan zijn, teneinde hun resocialisatie te vergemakkelijken,

VASTBESLOTEN elkaar, in aanvulling op de regels en voorwaarden bepaald in het op 21 maart 1983 te Straatsburg ondertekende Europees Verdrag inzake de overbrenging van gevonnisse personen, de ruimst mogelijke samenwerking te verlenen betreffende de overbrenging van personen veroordeeld tot vrijheidsberovende straffen,

ZIJN OVEREENGEKOMEN als volgt: